

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirembajtje e zakonshme ne shkolla dhe kopshte”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):98300000-6
Shërbime të ndryshme

VLERA E FONDIT LIMIT: **4.166.666(kater milion e njeqind e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Vau Dejës** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Kriteret e kualifikimit janë të njëjta për të gjitha lotet.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës në masën 2 % të fondit limit, me vlerë 83.333(tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre)lek, sipas Shtojcës 3;*

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 2(dy) viteve të fundit (2024, 2025) të certifikuar nga organet tatimore. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse në të dy bilancet e kerkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

***Shëmin:** Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2026 (sipas kesteve të maturuara) sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vetë. *((Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore)).*

Mbështetur në nenin 26, pika 6 e VKM-së nr 285 , date 19.05.2021, në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së të vlerës së përlogaritur të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77”Kërkesat për kualifikim”, të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4..”ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që

garantojnë se operatorët ekonomike zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvorjen e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomike të kenë një nivel të mjaftueshëm përvorje që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën” dhe nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për kontrata të mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”

Argumentimi Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvorjen e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të shërbimit të kërkuar objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontrata të ngjashme, të jetë afer limitit maksimal të lejuar dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçensë profesionale lëshuar nga organet perkatese, e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-3 Niveli A “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash”

Punime speciale ndërtimi:

Kategoria NS-4 Niveli A “Punime për prishjen e ndertimeve ...”

Parashikohet edhe mundësia e ekuivalentimit të liçencave profesionale për operatorët e huaj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për liçencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon liçencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i

kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente duke u bazuar ne kerkesat specifike te percaktuara ne termat e references.

Bazuar në objektivat e projektit dhe komponentët kryesorë të tij janë përcaktuar kategoritë e mësipërme të licensës së projektimit të Operatorit Ekonomik të cilat janë të domosdoshme për hartimin e projektit dhe përputhen me natyrën e shërbimit dhe sipas detyres se projektimit.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në pdrputhje me standartet kombëtare ose europiane.." Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zerrat e punimeve te ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria</u> NP-3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash	Punimet sipas preventivit zeri nr (1,2,4,6,10,1,12,13)	Niveli A	901,369.05 leke pa tvsh
<u>Kategoria</u> <u>NS-4</u>	“Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese”	Punimet sipas preventivit zeri nr (3,5,7,8,9)	Niveli A	3,265,296.95 leke pa tvsh

2.3.3 Kapaciteti Teknik (Fuqia Punëtore)

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate, duhet të disponojë një fuqi punëtore minimale prej **8 (tetë)** personash për muajin e fundit përpara datës së dorëzimit të ofertës. Lidhur me këtë pikë, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga Administrata Tatimore (Dega e Tatim-Taksave) ose Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore, ku pasqyrohet numri i punonjësve të siguruar për periudhën e sipërcituar, shoqëruar me listëpagesat përkatëse E-Sig për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

(Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues).

Mbështetur në nenin 26, pika 6 e VKM-së nr 285 , date 19.05.2021, në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi

Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", dhe nenit 41, pika 4, gërma "c" të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", përmes këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë fuqinë punëtore të nevojshme dhe të kualifikuar për ekzekutimin me sukses të objektit të prokurimit.

Përcaktimi i numrit minimal prej 8 punonjësish është bazuar në specifikat e shërbimit të mirëmbajtjes dhe në eksperiencën e suksesshme të autoritetit kontraktor ndër vite për kontrata të ngjashme.

Përlllogaritja e fuqisë punëtore sipas Manualit të Punës:

- Afati i ekzekutimit: 2 (dy) muaj.
- Sasia totale e orëve të punës (sipas manualit): 3,452.7 orë.
- Përlllogaritja: $3,452.7 \text{ orë} \div 8 \text{ orë/ditë} = 431.6 \text{ ditë pune} \div 60 \text{ ditë kalendarike} = \sim 8 \text{ punonjës}$.

Struktura e nevojshme e personelit:

- 1. Teknik Ndërtimi (1 punonjës):** Nevojitet për organizimin, ndjekjen dhe drejtimin e punimeve në objekt.
- 2. Shofer i mjeteve të rënda (1 punonjës):** Nevojitet për transportin e materialeve dhe mjeteve të punës.
- 3. Muratorë (2 punonjës):** Nevojiten për kryerjen e punimeve të ndryshme të ndërtimit (Përlllogaritja: $930 \text{ orë} \div 8 \div 60 \text{ ditë pune} = 1.9$, e rrumbullakosur në 2 punonjës me kohë të plotë).
- 4. Bojaxhinj (4 punonjës):** Nevojiten për lyerjen me bojë të ambienteve të brendshme dhe të jashtme (Përlllogaritja: $1,741 \text{ orë} \div 8 \div 60 \text{ ditë pune} = \sim 3.6$, e rrumbullakosur në 4 punonjës me kohë të plotë).

Totali i kërkuar: 1 Teknik + 1 Shofer + 2 Muratorë + 4 Bojaxhinj = 8 punonjës.

Kërkesa për paraqitjen e vërtetimit nga Administrata Tatimore dhe listëpagesave E-Sig mbështetet në Nenin 41, pika 8 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, sipas së cilës: *"Autoriteti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës"*.

2.3.4 Personeli Kryesor (Inxhinieri)

Operatori ekonomik, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë në stafin e tij personelin kryesor: **1 (një) Inxhinier Ndërtimi.**

Inxhinieri duhet të jetë i siguruar dhe të figurojë në listëpagesat përkatëse E-Sig të operatorit ekonomik për të paktën muajin e fundit përpara datës së dorëzimit të ofertës. Lidhur me këtë pikë, operatori ekonomik duhet të vërtetojë plotësimin e kriterit përmes paraqitjes së:

- a) Kontratës individuale të punës.
- b) Diplomës universitare për Inxhinieri Ndërtimi.

(Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues).

Mbështetur në nenin 26, pika 6 e VKM-së nr 285 , date 19.05.2021, në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi

Kjo kërkesë është përcaktuar në bazë të nenit 77, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", dhe nenit 41, pika 4, gërma "b" të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në përputhje me kërkesat e shprehura në Termat e Referencës.

Përmes këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë stafin e nevojshëm dhe të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Inxhinieri i ndërtimit është i domosdoshëm për zbatimin e punimeve në përputhje me zërat e preventivit, projektit dhe specifikimet teknike. Ai mban përgjegjësi direkte për zbatimin e saktë të projektit, ndjekjen e grafikut, si dhe për cilësinë e materialeve që vendosen në objekt.

2.3.5 Vetëdeklarimi i Disponueshmërisë

Paraqitja e një Vetëdeklarimi nga Inxhinieri i Ndërtimit (personeli kryesor), ku konfirmohet në mënyrë eksplicite se ai është plotësisht i disponueshëm për angazhim dhe realizimin e kësaj kontrate përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së saj.

Argumentimi

Kërkesa e mësipërme bazohet në Rekomandimin Nr. 6732, datë 21.10.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) "Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit", me qëllim shmangien e angazhimit fiktiv të të njëjtit inxhinier në disa procedura apo kontrata paralele në të njëjtën kohë.

2.3.6 Drejtuesi Teknik i Punimeve

Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklarate të nënshkruar nga Administratori i shoqërisë, duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt. Ky person duhet të jetë i përfshirë si drejtues teknik në licencën profesionale të shoqërisë dhe të figurojë i punësuar me kohë të plotë në listëpagesat e kompanisë.

Bashkëlidhur deklaratës së Administratorit, duhet të paraqiten dokumentet e mëposhtme:

- a) Curriculum Vitae (CV) e Drejtuesit Teknik.
- b) Kontrata individuale e punës (me kohë të plotë).
- c) Diploma universitare përkatëse.

(Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues).

Mbështetur në nenin 26, pika 6 e VKM-së nr 285 , date 19.05.2021, në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 41, pika 4, gërma "b" të VKM-së nr. 285/2021, si dhe në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar. Çdo objekt zbatimi duhet të ketë drejtuesin e tij teknik të licencuar, i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me këtë kuadër ligjor dhe me VKM-në Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier".

2.3.7 Kualifikimet e Veçanta dhe Dëshmitë e Sigurimit Teknik

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se stafi i kërkuar në pikën 2.3.3 zotëron kualifikimet dhe dëshmitë e nevojshme të sigurimit teknik për proceset specifike të punës. Punonjësit duhet të jenë të pasqyruar në listëpagesa për të paktën muajin e fundit dhe të pajisur me kontratë pune të vlefshme (ose të kontraktuar me marrëveshje të vlefshme si manovratorë/shoferë në rastet kur mjetet/makinertë merren me qira).

Struktura e kualifikimeve duhet të përmbajë minimalisht:

- Teknik Ndërtimi – 1 (një) punonjës: Duhet të paraqesë diplomën e shkollës profesionale ose dëshmi kualifikimi nga institucione të akredituara.
- Muratorë – 2 (dy) punonjës: Duhet të zotërojnë dëshmi kualifikimi profesional dhe të sigurimit teknik (të vlefshme), të lëshuara nga organizma të akredituar në Republikën e Shqipërisë.
- Bojaxhinj – 4 (kater) punonjës: Duhet të zotërojnë dëshmi kualifikimi profesional dhe të sigurimit teknik (të vlefshme), të lëshuara nga organizma të akredituar në Republikën e Shqipërisë.
- Shofer kamioni (mjete të rënda) – 1 (një) punonjës: Duhet të jetë i specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda, duke paraqitur Lejen e Drejtimit përkatëse (klasa e kërkuar) të lëshuar nga DPSHTRR, si dhe dëshminë e sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur në fazën e dorëzimit të ofertës përmes plotësimit të Shtojcës 9 të DST. Dokumentet provuese (diplomat, dëshmitë e kualifikimit dhe licencat e DPSHTRR/ISHTI) do të paraqiten vetëm në rastin kur operatori shpallet fitues ose nëse kërkohen sqarime zyrtare.

(Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues).

Mbështetur në nenin 26, pika 6 e VKM-së nr 285 , date 19.05.2021, në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi

Në bazë të pikës 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/c dhe pika 6 të VKM-së nr. 285/2021, ky kriter garanton që personeli zbatues të ketë kualifikimin e duhur teknik dhe njohuritë mbi mbrojtjen në punë, specifikisht:

1. **Muratorët:** Realizojnë ndërtimin, vendosjen e shtresave dhe suvatimin e mureve të brendshme/të jashtme dhe tavaneteve të godinave, duke garantuar sipërfaqe të rregullta sipas grafikëve të organizimit.
2. **Bojaxhinjtë:** Merren me përgatitjen e sipërfaqeve të strukturave për lyerje, përgatitjen e materialeve dhe lyerjen/dekorimin e ambienteve sipas specifikimeve të projektit.
3. **Shoferi i kamionit:** Është i domosdoshëm për transportin e materialeve ndërtimore, inerteve dhe sjelljen e tyre në kantier në koordinim të plotë me grafikun e punimeve.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë se disponon minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit:

Nr	Mjetet	Sasia
1	Mjet transporti veteshkarkues deri 3.5 - 5 ton (kapac.mbjates)	1 copë
2	Pompe suvatimi	1 copë

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

- Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.
- Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

(Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues).

Mbështetur në nenin 26, pika 6 e VKM-së nr 285 , date 19.05.2021, në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ c), pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Mjet transporti vetshkarkues 3.5- 5 ton (ngarkesa)

Transport material te ndryshme -246 ton

Totali 246 ton : 60=4.1 ton ,mesatarisht 1-2 rruge ne dite

Pompa e suvatimit sherben per te realizuar zerin suva brenda mur tulle.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to.